



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 27.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 26.11.2024, të parashtruar nga Operatori Ekonomik **LIMITPROJECT SH.P.K.**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac” me nr. i prokurimit- 632-24-11422-5-1-1, nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Aprovohet** si pjesërisht e bazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: **LIMITPROJECT SH.P.K.**, e dt.26.11.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac”**, Nr. i prokurimit- 632-24-11422-5-1-1, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 31.10.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Korrigjohet pjesërisht DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË , i publikuar me datë: 31.10.2024;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të bëj korigjimin e pjesërishtëm të Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

Ar sy e t i m

Operatori Ekonomik **LIMITPROJECT SH.P.K.**, me dt.26.11.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac**”, **Nr. i prokurimit- 632-24-11422-5-1-1.**

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 27.11.2024, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Licenca e kërkuar për menaxhimin e mbeturinave është licencë për administrimin e mbeturinave, lëshuar sipas Ligjit për Mbeturinave nr. 04/L-060 dhe U.A. Nr. 09/2014 – nga Ministrie e Ekonomisë.
2. Për këtë pikë kemi bërë plotësimin e kësaj kërkesë.
3. Staf i teknik i kërkuar, përkatësisht teknikët e kërkuar shkollimi i tyre mund të dëshmohet me diplomë të shkollës së mesme apo me certifikatë që tregon se personi ka aftësi teknike për kryerjen e punëve teknike që janë kërkuara.
4. Për sqarimet e pajisjeve që keni kërkuar, mendojmë se janë mjaft të qarta dhe të përshkruara mjaftueshëm, për çdo pa qartësi konsultoni një njohës të makinave punuese ose kërkoni në internet për të sqaruar llojin e tyre.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.**

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit